

VENDIM
Nr. 64/2013

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PARLAMENTARE PËR AUDITIMIN E VEPRIMTARISË
EKONOMIKE TË KLSH-SË

Në mbështetje të nenit 78, pika 1 të Kushtetutës, të nenit 55, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, dhe të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, të ndryshuar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të fillojë procedurat parlamentare për auditimin e veprimtarisë ekonomike të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

II. Me qëllim ushtrimin e auditimit, sipas legjislacionit në fuqi, ngarkohet Komisioni për Ekonominë dhe Financat për përzgjedhjen e audituesve të jashtëm të pavarur për kontrollin e veprimtarisë ekonomike të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilët do t’i paraqiten Kuvendit për miratim.

III. Komisioni për Ekonominë dhe Financat t’i paraqesë për shqyrtim Kuvendit raportin përfundimtar për audituesit e pavarur të përzgjedhur brenda datës 17.12.2013.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 26.11.2013